



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

**Anr.670/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ekrem Çitaku, votues nga Prishtina paraqitur kundër Kryesuesit të VV 02 në SHFMU “Ismail Qemali” Prishtinë, për shkak të kërcënimeve gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet Lokale 2021 të datës 17.10. 2021, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10. 2021, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.670/2021, e Ekrem Çitaku, votues nga Prishtina, për shkak të kërcënimit në Qendrën e Votimit në shkollën fillore SHFMU “Ismail Qemali” në Prishtinë, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

### **A r s y e t i m**

Më datën 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Ekrem Çitaku, votues nga Prishtina me të cilën pretendohet se më datë 17.10.2021 rreth orës 16:00 ka shkuar për të votuar në qendrën e votimit që gjendet në SHFMU “Ismail Qemali” në Prishtinë, dhe pasi është njoftuar nga personat zyrtarë, ka votuar tek vendvotimi numër 02. Më tutje, theksoi se te klasa e vendvotimit pas procedurave standarde të verifikimit, ka marrë dy fletëvotime dhe pasi i ka plotësuar ka pyetur kryesuesin e asaj qendre se a mundet dikush t’i fotografojë me dy vajzat e tij të vogla (njëra shtatë vjeçare dhe tjetra nëntë vjeçare) duke i vendosur fletëvotimet e palosura në kuti të votimit, siç ka theksuar që t’i ketë “kujtim” duke i hedhur fletëvotimet në kuti ashtu si e ka praktikuar edhe në votimet e kaluara. Në vazhdim të ankesës, votuesi Ekrem Çitaku ka theksuar se kryesuesi i vendvotimit lidhur me fotografimin e kërkuar iu është përgjigjur JO dhe ai ka respektuar vendimin e tij, por pasi ka dalur nga vendi i votimit i ka thënë se vendimi i tij ishte i pabazuar duke i thënë se mund ta shikojnë në internet se një pjesë e madhe e qytetarëve fotografohen duke hedhur fletëvotimet e tyre në kuti. Më tutje pretenduesi i ankesës ka theksuar se pasi iu është mohuar e drejta për tu fotografuar, kryesuesi i VV ishte ngritur në këmbë dhe në prezencë të vajzave dhe nënës së tij

e kishte kërcënuar me fjalët siç e ka cituar “unë ty tani kam me të qu me të lidhë”. Poashtu i njëjti thekson se e ka ndjekur edhe në koridor duke ia cituar të njejtët fjalë dhe në momentin që ka filluar ti frikësohen vajzat dhe ai nuk ndalet, kishte inqizuar me telefon kryesuesin e VV duke i përsëritur të njejtat fjalë kërcënuese.

Pretenduesi i ankesës kishte theksuar se nga policia e kishte kuptuar se kërcënuesi në fjalë quhet Isak Maxhuni dhe rreth orës 17:35 të datës 17.10.2021, polici me gradë rreshter z.Faton Topalli ka kërkuar nga ai që në emër të prokurores të fshijë video inqizimin nga telefoni i tij ku shihet dhe dëgjohet duke e kërcënuar z. Isak Maxhuni. Pretenduesi në ankesë nuk ka pranuar ta fshijë inqizimin dhe është shqetsuar se si mund një polic me gradën rreshter me kërkes të prokurorës të kërkoj të fshijë video inqizimin dhe i njëjti informon se këtë video inqizim duke u kërcënuar nga kryesuesi i VV nuk e ka publikuar në asnjë medium dhe rrjete social e as në ambasadat e Quintit në Kosovës, pasi që i beson drejtësisë Kosovare.

Pretenduesi ankesës në fund ka theksuar se beson në punën profesionale PZAP-it, dhe është në dispozicion për çdo informacion plotësues.

Parashtruesi i ankesës lidhur me pretendimet e tij në cilsinë e provës ka bashkangjitur disa fotografi ku shihen qytetarët e Kosovës duke u fotografuar deri sa hedhin në kuti fletëvotimet ndërsa video inqizimin thekson se nuk e ka bashkangjitur për shkaqe sigurie që mos ti humbet si provë dhe nëse i kërkohet nga PZAP-i do ta sjellë.

Paneli, pasi që shqyrtoi ankesën, në kuptm të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Nga raporti i Policisë së Kosovës, i datës 19.10.2021, paneli konstatoi se pretendimet në ankesë janë të pabazuara lidhur me kërcënimin e votuesit. Në polici ky rast është raportuar dhe pas pranimit të informatës policia ka shkuar në shkollën e lartcekur me të cilën kanë kuptuar se njëri nga votuesit kishte hasur në mosmarrveshje me kryesuesin e VV. Pas marrjes së deklaratës nga qytetari dhe kryesuesi i VV se kërkesa e qytetarit për ti fotografuar vajzat e tij duke futur fletëvotimin në kuti, kryesuesi i VV nuk e ka lejuar duke iu përgjigjur se që sipas tij është e ndaluar përdorimi i telefonit me të cilën shihet edhe shenja në klasë. Pretendimet e votuesit i cili ka theksuar se kryesuesi i VV iu është përgjigjur në mënyrë arrogante në raportin policor theksohet se e kanë njoftuar edhe hetuesin e krimeve regjionale

dhe prokurorin dhe pas spjegimit të situatës në tërsi i njejtë kishte urdhëruar që mos të hapet rast sepse nuk ka pasur ndonjë element të veprës penale.

Ndërsa nga provat që gjenden në shkresat e lëndës shihen vetëm fofografit e disa qytetarëve duke votuar dhe video inqizimin me të cilën vetëm është cekur por nuk iu ka bashkangjitur ankesës. Parashtruesi i ankesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij se kryesuesi i VV në shkollën Ismaj Qemali e ka kërcënuar në mënyrë arrogante dhe se ka bërë shkelje të dispozitës ligjore të nenit 34 par.1 dhe 2 të LZP-së, ashtu siç pretendohet në ankesë.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe hetuar me kujdes të gjitha provat dhe nga raporti policor konstatohet se nuk ka pasur elemente të veprës penale dhe se lidhur me këtë nuk është hapur asnjë rast, ka vërtetuar në mënyrë të padyshimt, se pretendimet ankimore janë pabazuar në ligj sepse të njëjtat, nuk mbështeten me asnjë provë nga parashtruesi i ankesës, andaj ankesa e ankuesit u refuzua si e pabazuar në kuptim të nenit 118 të LZP-së.

Nisur nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.670/2021 më datën 20.10.2021.

**Kryesuesi i Panelit**  
Rrustem Thaçi



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.